URDHËR
Nr. 154, datë 1.6.2022

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58 datë 29.1.2004, "Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar"; të nenit 26 të "Rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar", miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, "Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore, znj. Klarita Bejko.
2. Znj. Klarita Bejko i delegohen kompetencat, si më poshtë:
- ndjek dhe zbaton "Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar" (të ndryshuar);
- ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të DSIK-së;
- ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;
- merr dhe trajton korrespondencën shkresore.
3. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 6.6.2022 deri 10.6.2022.
4. Znj. Klarita Bejko nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.
5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore.
6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.
7. Ky urdhër hartohet në 2 (dy) kopje të njëjta, një për protokoll-arkivin dhe një për Drejtorin e Drejtorisë së Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola